

VENDIM
Nr. 177, datë 4.11.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “MOBIGAS ALBA” SHPK, PËR T’U TËRHEQUR
NGA APLIKIMI PËR T’U LICENCUAR NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 16, 64 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/7 prot., datë 30.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., për t’u tërhequr nga aplikimi për pajisje me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 8.6.2020, vendosi: “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152/2020, vendosi të shtyjë afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

- Sa më sipër iu bë me dije shoqërisë me shkresën nr. 723/11 prot., datë 8.10.2020, dhe, përveç kërkesës për plotësimin e dokumentacionit të munguar, iu kërkua të specifikojë/saktësojë mënyrën e operimit të veprimtarisë për të cilën ka aplikuar.

- Shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k., me shkresën e datës 20.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 723/12 prot., datë 20.10.2020, ka kthyer përgjigje për sa kërkuar nga ERE, duke u shprehur, se nga korrespondenca e zhvilluar me ERE-n, si dhe nga vlerësimi sistematik i legjislacionit që rregullon licencimin e subjekteve për aktivitetet e ushtruara lidhur me depozitimin/impianetet e GNL-së, ashtu edhe për tregtimin e GNL-së nga ERE apo nga çdo autoritet tjetër licencues në Republikën e Shqipërisë, shoqëria ka arritur në përfundimin se ka një mangësi të dukshme në rregullimin e fushës së industrisë së njohur ndryshe si “small LNG” ose “mini LNG”, ku karakteristikë kryesore e kësaj mënyre operimi është shtrirja në territore të pambuluara nga rrjeti i gazit apo tubacionet direkte.

- Në përfundim shoqëria ka deklaruar se nuk mund të përmbushë kërkesat e ERE-s për aplikimin e kryer për licencë.

- Duke qenë se aplikuesi është tërhequr nga kërkesa për licencim, në kuptim të parashikimeve të nenit 64 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, ka rënë shkaku ligjor për të cilin filloi kjo procedurë administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., për pajisje me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë) mbështetur në kërkesën e aplikuesit.

2. Të shfuqizojë vendimin nr. 96, datë 8.6.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti